



Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

**Komente në Raportin Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për
Energji mbi Shqyrtimin e Strukturës Tarifore për Konsumatorët e
Rregulluar të Amvisërisë të shërbyer nën FSHU**

Prishtinë, 2022

Hyrje

Me datë 17 janar 2022, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) propozoi strukturë të re dhe lartësi të re të çmimeve të energjisë. Me strukturën e re të propozuar, ZRRE ka rikthyer strukturën tarifore me blloqe të konsumit. Në këtë formë, kufiri mes dy blloqeve do të jetë konsumi prej 600 kWh. Paraprakisht, një model i tillë i klasifikimit të tarifave energjetike ka qenë në fuqi dhe ka pasur për synim kategorizimin e niveleve të shpenzimit me qëllim të inkurajimit të kursimit dhe subvencionimit të çmimit për një pjesë të konsumatorëve.

Blok-tarifat kanë qenë pjesë e strukturës tarifore të energjisë elektrike në Kosovë nga viti 2006 deri në vitin 2017. Modeli i strukturës tarifore ka qenë i bazuar në disa parametra, siç janë lloji i konsumatorit, konsumi, koha e konsumit dhe sezona e konsumit.¹ Blok-tarifa ka qenë e ndarë në nivelin e konsumit prej 600 kWh, ku rrjedhimisht edhe ka pasur sukses në uljen e nivelit të konsumit të energjisë elektrike nga konsumatorët.

Struktura e re tarifore dhe propozimi i ZRRE-së ka nxitur debat dhe reagim të gjithëmbarshtëm shoqëror. Kritikkat janë fokusuar në faktin që për një pjesë të konsumatorëve, struktura dhe modeli i ri do të shkaktoj rritje të çmimit të energjisë. Sipas propozimit të ZRRE-së, çmimi i energjisë elektrike do të rritet për 9% për konsumatorët biznesorë dhe për nivelin e konsumit deri në 600 kWh të konsumatorëve shtëpiak. Duke e ditur se Kosova me kapacitetet aktuale gjeneruese që ka nuk mund të mbulojë të gjithë kërkesën për energji elektrike dhe atë sasi të energjisë elektrike që i nevojitet e importon, atëherë propozimi i ZRRE-së është që për konsumatorët që shpenzojnë më shumë se 600 kWh, çmimi i energjisë të jetë 0.21 eur/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.09 eur/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët.

Kjo analizë është pjesë e programit të INDEP për zhvillim të qëndrueshëm dhe përpjekjeve të institutit që të kontribuoj në promovimin e rritjes së qëndrueshme dhe politikave që ndihmojnë tranzicionin energjetik dhe socio-ekonomik. Analiza do të dërgohet si pjesë e komenteve në diskutimin publik të organizuar nga ana e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Ajo është e ndarë në tre pjesë kryesore. Në pjesën e parë ne kemi trajtuar strukturën tarifore me blloqe ku kemi shpjeguar pozicionin konsistent të INDEP-it mbi nevojën për vendosjen e bllok tarifave. Në pjesën e dytë kemi trajtuar propozimin e ZRRE-së ndërsa në pjesën e fundit kemi paraqitur modelin e propozuar nga INDEP. Në fund kemi paraqitur rekomandimet kryesore për ZRRE-në bashkë me të dyja modelet të paraqitura në formë tabelare për të theksuar dallimet mes tyre.

¹ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2014), Raport Konsultativ rreth Strukturës Tarifore, faqe 4, e qasshme në http://eroks.org/Tarifat/2014/Raporti_konsultativ_per_strukture_tarifore.pdf (qasur në janar, 2022)

Struktura tarifore me blloqe

Bloku tarifor apo struktura tarifore me blloqe paraqet mënyrën e faturimit të energjisë elektrike që konsumohet apo shfrytëzohet në atë mënyrë që bazuar në kufinj të konsumit, sa më shumë që konsumohet aq më shtrenjtë faturohet. Kjo do të thotë që për një sasi të energjisë elektrike paguhet me një kosto të caktuar, ndërsa me rastin e tejkallimit të shfrytëzimit të nivelit të caktuar të energjisë elektrike, tarifimi ndryshon dhe rrjedhimisht rritet kosto për sasinë e energjisë elektrike të shfrytëzuar. Synimi kryesor i strukturës tarifore me blloqe është që të nxitet zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike. Për më tepër, në raste të caktuara, siç ishte modeli i para vitit 2017, struktura në blloqe përdoret për të subvencionuar sasi të konsumit në atë mënyrë që shkalla e parë e konsumit tarifohet nën çmimin real të rrymës ndërsa shkalla e fundit faturohet mbi çmimin real të produktit. Kjo natyrë “sociale” e bllok tarifës konsiderohet e tejkalluar dhe subvencionimi i konsumatorëve në nevojë përcaktohet nga korniza e politikave të ndara qeveritare dhe jo nga Rregullatori përmes tarifimit diskriminues.


Për gjatë periudhës 2006-2017, Kosova ka përdorur strukturën tarifore me blloqe. Atë kohë, mënyra e funksionimit të kësaj strukture është bazuar nga lloji i konsumatorit, niveli i konsumit, sezona dhe tarifa e lartë apo e ultë varësisht nga koha e shpenzimit, ditën apo natën.² Gjithashtu, më e rëndësishmja, çmimi ndahej edhe në bazë të konsumit duke kategorizuar tre shkallë të konsumit: deri në 200 kWh, 200-600 kWh dhe mbi 600 kWh. Një ndarje e tillë kishte paraqitur sukses në objektivin kryesor që kishte kjo strukturë, e cila ishte zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike.

Struktura tarifore me blloqe paraqet benefite për sistemin energjetik të Kosovës. Përmes strukturës së tillë, nxitet zvogëlimi i përdorimit të energjisë elektrike, pasi që me rastin e tejkallimit të kufirit tarifor, aplikohen tarifa më të mëdha për sasinë e energjisë së konsumuar. Pra kjo strukturë nxit konsum më të ulët të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët për shkak të kufizimeve të prodhimit vendor të energjisë elektrike, e të cilat tashmë dihet se nuk e mbulojnë të gjithë kërkesën që kanë konsumatorët e Kosovës. Ndër të tjera, me rastin e zvogëlimit të nivelit të konsumit, zvogëlohet edhe kërkesa apo nevoja për import të energjisë elektrike. Rrjedhimisht zvogëlimi i konsumit dhe zvogëlimi i nevojës për import të energjisë elektrike, ndihmojnë avansimin e sigurisë së tregut energjetik të Kosovës dhe ndihmojnë në arritjen e qëndrueshmërisë energjetike afatgjate.

Efiçienca e energjisë inkurajohet përmes strukturës tarifore me blloqe. Duke aplikuar masat e efiçencës së energjisë, ndihmohet zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike dhe me këtë rast evitimi i tarifave të ngritura si pasojë e bllokut tarifor. Prandaj largimi i strukturës tarifore të aplikuar para vitit 2017 ka dekurajuar qytetarët e Kosovës në aplikimin e masave të efiçencës së energjisë, e kjo ka reflektuar në rritjen e konsumit të energjisë elektrike vit pas viti.

² Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Struktura e re tarifore, e qasshme në https://indep.info/wp-content/uploads/2017/03/Analiza-pe%CC%88r-strukturen-tarifore-te-ZRRE.pdf?fbclid=IwAR1dJqbUE5JSf2UIaYcI_06VbO_PgNIX6Vk5mgz4njQt0RUgXdvR0UX4iE4, (qasur në janar, 2022)

KËRKESA E PËRGJITHSHME E ENERGJISË ELEKTRIKE 2015-2020 (GWH)



Struktura tarifore me blloqe penalizon konsumatorët që shpenzojnë apo konsumojnë sasi të energjisë elektrike mbi kufirin e bllokut tarifor. Një gjë e tillë ndodh pasi që çmimi i energjisë elektrike për sasinë e shpenzuar mbi kufirin e bllokut tarifor rritet. Tarifat e ngritura për këtë sasi të energjisë elektrike aplikohen për shkak të nxitjes së kursimit të energjisë elektrike, por edhe në mënyrë që të mos preket gjendja financiare e konsumatorëve.

Për arsyet e sipërpërmendura, INDEP përkrahë idenë që për sa kohë çmimet të jenë të rregulluara, të rivendoset bllok-tarifa. Për rrjedhojë, **në parim përkrahim propozimin e ZRRE-së për rikthim të blloqeve tarifore bazuar në shpenzimin bashkë me arsyetimet e dhëna që janë në konsistencë të plotë me paralajmërimet e INDEP që në vitin 2017.**³ INDEP kishte paralajmëruar që largimi i kësaj strukture tarifore do të paraqiste rrezik në furnizimin me energji elektrike, e një gjë e tillë po reflektohet sot, pesë vite më vonë. Rikthimi i strukturës tarifore me blloqe ndihmon kontrollimin e konsumit, zvogëlon nevojën për import të energjisë elektrike dhe vë në pah parimin se energjia është nevojë e gjithsecilit por në të njëjtën kohë shpenzimi në nivele të larta të saj paraqet problematikë në aspektin e plotësisht të kërkesës së përgjithshme.

³ Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Struktura e re tarifore, e qasshme në https://indep.info/wp-content/uploads/2017/03/Analiza-pe%CC%88r-strukturen-tarifore-te-ZRRE.pdf?fbclid=IwAR1dJqbUE5JSf2UIaYcI_06VbO_PgNIX6Vk5mgz4njQt0RUgXdvR0UX4iE4, (qasur në janar, 2022)

Modeli i propozuar nga ZRRE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) përmes raportit konsultativ të shqyrtimit të strukturës tarifore për konsumatorët e rregulluar të amvisërive të shërbyer nën FSHU, ka propozuar për ngritje të çmimeve të energjisë elektrike dhe rikthim të strukturës tarifore me blloqe. Një shqyrtim i jashtëzakonshëm i tarifave erdhi si pasojë e ngritjes së çmimit të importit të energjisë, nivelit të ulët të rezervave të gazit në botë, rënies së blloqeve të termocentraleve ekzistuese në Kosovë, ndikimit të pandemisë COVID-19 dhe rritjes së kërkesës për energji elektrike, e cila këtë vit arriti në nivelin më të lartë. Duke llogaritur faktorët e lartpërmendur dhe duke kalkuluar kërkesën për vitin 2022, ZRRE ka njoftuar që kostoja e furnizimit gjatë vitit të ardhshëm tarifor është 446.7 milionë Euro (€), ndërsa të hyrat që mund të mbulohen nga shitjet me tarifën ekzistuese janë 314 milionë Euro (€).⁴ Andaj për mbulimin e kësaj kostoje, ZRRE ka propozuar masat si në vijim:

1. Tarifat e shërbimit të energjisë elektrike të rriten për 9% për komponentën e energjisë të tarifave për konsumatorët biznesorë dhe për nivelin e konsumit deri në 600 kWh në muaj të konsumatorëve shtëpiak
2. Të rikthehet struktura tarifore me blloqe, ku ndarja do të bëhet në nivelin e konsumit të energjisë elektrike prej 600 kWh në muaj
3. Për konsumatorët që tejkalojnë nivelin e konsumit prej 600 kWh në muaj, të aplikohen tarifatat prej 0.21 €/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.09 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët

Tarifatat aktuale të energjisë elektrike në Kosovë për sektorin e amvisërisë janë 0.0675 €/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.0289 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët. Me tarifatat e reja të propozuara nga ZRRE, çmimi për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë kur niveli i konsumit është mbi 600 kWh, rritet për 211.111%, ndërsa çmimi për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së ulët rritet për 211.419%. Ngritja e tillë e çmimeve shkakton vështirësi të mëdha në përbalimin e këtyre tarifave nga ana e konsumatorëve.

- Sipas propozimit të ZRRE-së, për nivelin e konsumit deri në 300 kWh në muaj energji elektrike, fatura do të rritet nga 18.87 € në 20.40 €, apo thënë ndryshe do të rritet për 8.1%
- Sipas propozimit të ZRRE-së, për nivelin e konsumit deri në 450 kWh në muaj energji elektrike, fatura do të rritet nga 27.37 € në 29.66 €, apo thënë ndryshe do të rritet për 8.36%
- Sipas propozimit të ZRRE-së, për nivelin e konsumit deri në 600 kWh në muaj energji elektrike, fatura do të rritet nga 35.86 € në 38.92 €, apo thënë ndryshe do të rritet për 8.53%

⁴ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Raport Konsultativ - Shqyrtimi i Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërive të shërbyer nën FSHU, e qasshme në https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20konsultative%20per%20strukturen%20tarifore_0.pdf, (qasur në janar, 2022)

INDEP duke llogaritur gjendjen aktuale, investimet në burime të ripërtëritshme, investimet në rrjetin ekzistues, sigurinë e furnizimit, zvogëlimin e importit e shumë të tjera përkrahë rritjen e çmimeve të tarifave të energjisë elektrike, por jo me përqindjen e propozuar nga ZRRE. Tarifat e rritura e të propozuara nga ZRRE-ja janë diskriminuese dhe të papërbalueshme për konsumatorët. Andaj duke pasur në mend të parë mbrojtjen e konsumatorit dhe barazinë e gjithsecilit, INDEP propozon tarifa me rritje por me përqindje më të zbutur krahasuar me ZRRE-në.

Modeli i propozuar nga INDEP

INDEP duke pasur në mend të parë barazinë e secilit shfrytëzues të energjisë elektrike në Kosovë, duke ditur gjendjen e jashtëzakonshme me furnizim të energjisë dhe vështirësitë e shkaktuara nga pandemia COVID-19, propozon që çmimi i energjisë elektrike të rritet me një përqindje më të ulët se sa që ka propozuar ZRRE. Gjithashtu, INDEP përkrahë strukturën tarifore me blloqe, por propozon që kategorizimi të jetë në tre blloqe. Duke shtyrë përpara uljen e konsumit dhe rritjen e masave eficiente, INDEP propozon masat si në vijim:

- Tarifat e shërbimit të energjisë elektrike të rriten për 5.5% për të gjithë konsumatorët, përfshirë konsumatorët komercial
- Të rikthehet struktura tarifore me blloqe për konsumatorët e amvisërisë, ku ndarja do të bëhet në tre nivele të konsumit të energjisë elektrike, deri në 600 kWh në muaj, nga 600 deri në 1,200 kWh në muaj dhe mbi 1,200 kWh në muaj
- Për nivelin e konsumit deri në 600 kWh në muaj energji elektrike, të aplikohen tarifatat prej 0.0712 €/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.0304 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët, apo 5.5% më të larta se tarifatat aktuale
- Për konsumatorët që tejkalojnë nivelin e konsumit prej 600 kWh në muaj, të aplikohen tarifatat prej 0.121 €/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.051 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët, apo 70% më të larta se tarifatat e bllokut të parë
- Për konsumatorët që tejkalojnë nivelin e konsumit prej 1,200 kWh në muaj, të aplikohen tarifatat prej 0.217 €/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.091 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët, apo 80% më të larta se tarifatat e bllokut të dytë

Në Kosovë çmimet e energjisë elektrike janë të rregulluar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), andaj kur çmimet janë të rregulluara në këtë formë, rol të rëndësishëm dhe pikë mbështetëse duhet të jetë parimi i barazisë. Me rastin e shtrenjtimit ose lirimit të çmimit të energjisë elektrike, duhet që të preken të gjithë konsumatorët në formë të barabartë. Duke parë krizën në të cilën gjendemi është shumë e rëndësishme të theksohet që të gjithë duhet të marrim përgjegjësi për atë që kemi shkaktuar dhe se çfarë mund të shkaktojmë në të ardhmen, në mënyrë që të tejkalojmë krizën dhe të kontribuojmë në arritjen e stabilitetit energjetik për të gjithë këtë sektor.

Shtrenjtimi i energjisë elektrike për konsumatorët të cilët shpenzojnë energji elektrike deri në 600 kWh në muaj nxit uljen e konsumit të energjisë elektrike. Mos shtrenjtimi për këtë kategori shpenzuese zvogëlon interesimin dhe mundin për të zvogëluar shpenzimet mujore të energjisë elektrike, andaj është e nevojshme që edhe sipas parimit të barazisë edhe kjo kategori të përfshihet në shtrenjtimin e energjisë elektrike. Vendosija e një kuote shtrenjtimi për të gjithë kategoritë shpenzuese të energjisë elektrike, përfshin të gjithë kategoritë në synimin për kursim të mëtutjeshëm dhe të shtuar të energjisë elektrike.

Krijimi i strukturës tarifore me tre blloqe, ku në bllokun e dytë kategorizohen konsumatorët që shpenzojnë 600 deri në 1,200 kWh në muaj energji elektrike, propozohet me arsyetimin që në

këtë kategori hyn familjet me të hyra të nivelit të mesëm. Këto familje nuk kanë opsione të ngrohjes qëndrore, të ngrohjes me dru ose pelet, apo qasje në ngrohoret e qytetit (një pjesë e konsumatorëve të Prishtinës dhe Gjakovës). Nga kalkulimet e INDEP, sasia e shpenzuar e energjisë elektrike për ngrohje tek konsumatorët që nuk e tejkalojnë sasinë e shpenzuar të energjisë elektrike prej 1,200 kWh në muaj, me çmimin aktual të energjisë (para këtij propozimi) është aktualisht thuasje e barabartë me koston që shpenzon e njëjta familje për ngrohje me dru ose pelet apo ngrohjes përmes alternativave të tjera. Duke qenë se forma e tillë e ngrohjes është e paqëndrueshme dhe çmimi aktual i energjisë elektrike e vë sistemin në presion të konsumit, INDEP propozon që për këtë kategori, diferenca e ngritjes së çmimit të jetë për 70% më e lartë sesa për konsumatorët që shpenzojnë më pak se 600 kWh në muaj energji elektrike. Rrjedhimisht kosto e energjisë elektrike për 1 kWh të shpenzuar në bllokun tarifor nga 600 kWh deri në 1,200 kWh në muaj do të jetë 0.12 €/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.049 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët.

Struktura tarifore me blloqe e propozuar nga INDEP, vendos në kategorinë e tretë konsumatorët që shpenzojnë më shumë se 1,200 kWh energji elektrike në muaj. Për konsum të energjisë elektrike mbi 1,200 kWh në muaj, INDEP konsideron që është jashtëzakonisht e rëndësishme që të bëhet ndarja në mes të sasisë së energjisë elektrike që është esenciale për një familje dhe sasisë së energjisë që është mbi këtë mesatare. Konsumatorët që shpenzojnë më shumë se 1,200 kWh energji elektrike në muaj, janë potencialisht konsumatorë të cilët kanë mundësinë e investimit në panele fotovoltaike për vetëgjenerim të energjisë elektrike apo investim në ngritjen e nivelit të efijencës së energjisë. Për këtë arsye dhe për synim të shkarkimit të sistemit elektroenergjetik nga kërkesa e tepërt, INDEP propozon që për këtë kategori të konsumatorëve, të aplikohen tarifa të energjisë elektrike që janë për 80% më të shtrenjta sesa sasia e konsumit nga 600 kWh deri 1,200 kWh e energjisë elektrike në muaj. Është shumë e rëndësishme që të bëhet dallimi mes sasisë së konsumit esencial dhe konsumit “të luksit”. Por ky kufi nuk mund të jetë vetëm deri tek 600 kWh në muaj, por duhet të theksohet në kufirin mbi 1,200 kWh në muaj. Më poshtë është dhënë tabela me strukturën tarifore me blloqe dhe çmimet e propozuara nga ZRRE dhe INDEP.

Në modelin e propozuar nga INDEP, diferenca e rritjes në bllokun tarifor 600 – 1,200 kWh është përafërsisht e njëjtë me shpenzimin e një familje për ngrohje nga Termokosi apo ngrohje me dru apo pelet!

Tabela 1. Propozimi i tarifave të energjisë elektrike nga ZRRE

Konsumatori	A	B	C	D	E
	Blokun i parë tarifor			Blokun i dytë tarifor	
Konsumi mujor	300 kWh	450 kWh	600 kWh	800 kWh	1000 kWh
Fatura ekzistuese	€ 18.87	€ 27.37	€ 35.86	€ 47.19	€ 58.52
Propozimi i ZRRE	€ 20.40	€ 29.66	€ 38.92	€ 74.17	€ 109.42
Ndryshimi (rritja)	€ 1.53	€ 2.29	€ 3.06	€ 26.98	€ 50.89

Tabela 2. Propozimi i tarifave të energjisë elektrike nga INDEP

Konsumatori	A	B	C	D	E	F	G
	Blloku i parë tarifor			Blloku i dytë tarifor			Blloku i tretë tarifor
Konsumi mujor	300 kWh	450 kWh	600 kWh	800 kWh	1000 kWh	1200 kWh	1400 kWh
Fatura ekzistuese	€ 18.87	€ 27.37	€ 35.86	€ 47.19	€ 58.52	€ 70.78	€ 82.58
Propozimi i INDEP	€ 19.90	€ 28.87	€ 37.83	€ 58.12	€ 78.42	€ 98.72	€ 135.25
Ndryshimi (rritja)	€ 1.03	€ 1.50	€ 1.97	€ 10.93	€ 19.90	€ 27.94	€ 52.67

Propozimi i INDEP është më i balancuar dhe ndonëse synon eficiencën për të gjitha grupet e konsumit, sigurohet gjithashtu që rritja të jetë dukshëm më e përballueshme për konsumin deri në 1,200 kWh. Gjithashtu, subvencionimi nga ana e Qeverisë duhet të përfshijë të gjitha kategoritë e konsumit dhe nuk duhet të jetë ekskluziv vetëm për konsumin deri në 600 kWh. Modeli i propozuar nga INDEP është gjithëpërfshirës dhe i barabartë. Mëton që duke përqafuar modelin e bllok tarifave, të synohet eficientia në të gjitha grupet e konsumit.

Përfundime dhe Rekomandime

Zyra e Rregullatorit për Energji të rishqyrtoj strukturën tarifore të propozuar në mënyrë që rritja e çmimit të energjisë të jetë më e përbalueshme, më gjithëpërfshirëse dhe të nxisë kursimin e të gjitha grupeve të konsumatorëve. ZRRE duhet që në mënyrë urgjente të punoj në ndryshimin e praktikave që do të mbronin konsumatorin, do të nxisnin uljen e kërkesës dhe do të inkurajonin rritjen e investimeve në sektorin e energjisë.

Struktura e propozuar me blloqe është e domosdoshme për sa kohë çmimet janë të rregulluara në nivelin e konsumatorëve shtëpiak dhe biznesor. Kështu, ndonëse inkurajojmë zbatimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e tregut, ne përkrahim propozimin e ZRRE-së për kthimin e bllok tarifave dhe aplikimin e çmimeve të ndryshme për kategori të ndryshme të konsumit. Jemi të kënaqur që ZRRE, pas pesë viteve, ka ardhur në përfundimet që INDEP ka pasur qysh në vitin 2017 kur është shqyrtuar heqja e bllok tarifave.

Ne konsiderojmë që shkalla e parë e rritjes duhet të përfshijë të gjithë konsumatorët. Kështu, ne kemi propozuar një rritje prej 5.5% për të gjithë konsumatorët. Kjo, ndonëse deri në nivelin e konsumit në 600 kWh nuk rezulton në rritje më të madhe sesa rreth 2 euro, është një mënyrë që duke përfshirë të gjithë konsumatorët në rritje, kursimi i rrymës të synohet për të gjitha kategoritë. Ne gjithashtu konsiderojmë që duke përfshirë edhe bizneset në rritjen e çmimit, ne inkurajojmë ndryshimin e sistemeve të ngrohjes, sjelljeve konsumatore dhe të inkurajojmë investimet në panele solare tek bizneset të cilat kanë mundësi që duke investuar të ulin shpenzimet operacionale.

Ne propozojmë tre shkallë të tarifave: deri në 600 kWh, nga 600 deri në 1,200 kWh dhe nivelin mbi 1,200 kWh të shpenzuara. Në mbrojtje të konsumatorëve me të hyra të mesme, ne konsiderojmë që dallimi prej 211% rritje për kategorinë mbi 600 kWh është jashtëzakonisht i lartë. Niveli i konsumit nga 600 deri në 1,200 kWh i përgjigjet familjeve të cilat nuk kanë alternativa të tjera të ngrohjes. Niveli i rritjes që ne kemi propozuar, është i barazvlefshëm me koston mesatare që një familje shpenzon për ngrohje nga ngrohësja e qytetit apo ngrohje me dru dhe alternativa të tjera. Dallimi në çmim që ne kemi propozuar është për 70% dhe ndonëse është më i vogël sesa mbi 200% sa ZRRE ka propozuar, prapë se prapë inkurajon eficiencën. Për nivelin e konsumit mbi 1,200 kWh ne kemi propozuar një rritje prej 80% nga çmimi i kategorisë deri në 1,200 kWh. Pra, tarifat e ditës për të tre kategoritë do të jenë: 7,12 cent kWh për kategorinë deri në 600 kWh, 12.1 cent kWh për kategorinë nga 600 deri 1,200 kWh dhe 21.79 cent kWh për kategorinë mbi 1,200 kWh. Për dallim nga ZRRE, për INDEP, çmimi prej 21 cent për kilovat është i arsyeshëm vetëm për sasinë e konsumit mbi 1,200 kWh dhe jo për çdo kilovat mbi 600.

ZRRE, të bashkëpunoj ngusht me Qeverinë e Republikës së Kosovës në mënyrë që shuma e zotuar për subvencionim të shpërndahet në mënyrë të barabartë në mes të grupeve të konsumit në skemën tarifore të re. Gjithashtu, varësisht nga nevoja, Qeveria duhet të jetë e hapur që të shtoj mjete në fondin e zotuar në mënyrë që dallimet në çmim në mes të kategorive të jenë sipas modelit të balancuar të propozuar nga INDEP dhe jo të ketë dallime astronomike në mes të niveleve nën dhe mbi 600 kWh.

INDEP i rekomandon ZRRE-së që të reformoj Skemën Mbështetëse për burime të ripërtëritshme të energjisë në atë mënyrë që me qëllim të zbutjes së efekteve të kësaj rritje, të inkurajohet përsheptimi i investimeve në burime të ripërtëritshme. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar konsumatorëve me vetkonsum (prosumers), më konkretisht reformimin e skemës mbështetëse për ta. Kufizimi nominal i lejuar për instalim duhet të hiqet dhe të ndërlihet vetëm me konsumin mesatar të konsumatorit që aplikon. Gjithashtu, KEDS duhet monitoruar që aplikimet për kyçje të konsumatorëve me vetkonsum të mos hasin në kërkesa teknike të panevojshme dhe burokraci të tepruar.

Gjithashtu, ZRRE duhet të intensifikoj monitorimin e ndërmarrjeve të energjisë në mënyrë që struktura e re tarifore të mos shfrytëzohet nga ana e ndërmarrjeve të energjisë për të dëmtuar interesat ekonomike të konsumatorëve. Një ekipë e veçantë e monitorimit duhet të ndërmarrë inspektime ad-hoc dhe bazuar në kërkesa në mënyrë që të drejtat e konsumatorëve të mbrohen.

Zyra e Rregullatorit për Energji, në zbatim të Nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe nenit 4 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, të ridizajnoj faturën e energjisë për konsumatorët në mënyrë që leximi i saj të jetë më i lehtë dhe më i kuptueshëm për konsumatorin. Për më tepër, ne rekomandojmë nisjen e një kampanje të vetëdijësimit mbi mënyrën e leximit të faturës dhe praktikave të eficiencës për reduktimin e shpenzimit të energjisë elektrike dhe rritjen e eficiencës.

Përfundimisht, ZRRE duhet të trajtoj me transparencë dhe seriozitet të gjitha komentet me shkrim të pranuar në kohën e konsultimit. Praktikave të injorimit të komenteve me shkrim në të kaluarën duhet të ndalohen. Standardet e konsultimit publik duhet të respektohen në atë mënyrë që komentet me shkrim të marrin përgjigje me shkrim nga ana e ZRRE-së. Ne jemi të shqetësuar me afatet kohore të paraqitura në këtë konsultim publik. Ndonëse afati për dërgim të komenteve është deri me datë 31 janar, propozimi i ZRRE-së në formë të vendimit të Bordit është paraparë të hyj në fuqi që nga 1 shkurti. Kjo, nuk i jep kohë të mjaftueshme ZRRE-së që seriozisht të konsideroj komentet e palëve në konsultimin publik. I bëjmë thirrje ZRRE-së që të marrë kohën e duhur për të shqyrtuar në mënyrë meritore të gjitha modalitetet e propozuara nga palët në këtë konsultim publik, në mënyrë që vendimi final të reflektoj kontributin e palëve dhe niveli i rritjes të mbuloj krizën aktuale, të nxisë eficiencën por edhe të jetë i përballeshëm.